

27 - 12 - 18

P.nr.864/18

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaj, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1121-3/18 te datës 22.06.2018, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt. 01.08.2018 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH në Ferizaj PP/II.nr.1121-3/18 te datës 22.06.2018, dhe kjo gjykatë jepë këtë:

## U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

I pandehuri: [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka te kryer shkollen e mesme, i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [REDACTED]

## Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse me datën 25.05.2018, rreth orës 20:40 përball autosallonit "Auto Model", në fshatin Prelez i Muhaxherëve, duke drejtuar automjeti e tipit "Mercedes 200", ngjyrë hiri, me targa [REDACTED], në drejtim të Ferizajt, nga pakujdesia rrezikon jetën e njerëzve, ashtu që në kundërshtim me nenin 120 par.1 të Ligjit mbi Trafikun Publik, nuk e mban distancën e sigurisë me mjetet të cilat lëvizin para tij në mënyrë që të ndalet para cdo pengese, për pasojë me pjesën e përroarme godet në pjesën e pasme automjetin e tipit "Audi E", ngjyrë e zezë, me targa [REDACTED], të cilin e drejtonte [REDACTED], me ç'rast lëndime të lehta trupore dyshohet se pësojnë drejtuesit e dy automjeteve, si dhe pasagjerja e njësisë dy [REDACTED] -

me të cilin kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 3,6,11,16,34,36,39,46 dhe 64 të KPK-së, si dhe nenit 495 të KPPK-së.

### G J Y K O N

Me dënim në gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] K Ferizaj, për realizmin e kërkesës pasurorë juridike, udhëzohet ne kontest juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që Gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej 20€, shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 60.88€ si dhe ne emër të fondit të kompensimit te viktimave të krimit shumën prej 30€ në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1121-3/18 te datës 22.06.2018, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR], për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.1121-3/18 te datës 22.06.2018, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Ekspertiza mjeko ligjore e dt. 04.06.2018, Mendimi dhe konstatimi i ekspertit te komunikacionit Ing. Dipl. [REDAKTUAR] e dt. 06.06.2018, Raporti i aksidentit 2018-CFT -283 si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, vërtetojnë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.864/18, me datë 01.08.2018**

**Zyrtarja ligjore**

**Ganimete Avdiu**

**Gjyqtarja Individuale**

**Hakile Ilazi**



#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.